KËRKESË
Nr. 421/1, datë 11.1.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Sistemim i bllokut të banimit në lagjen 'Xhevdet Nepravishta' kufizuar me rrugën 'Ahmet Zogu', rrugën 'Misto Mame' dhe shëtitoren 'Kongresi'", Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, "Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "truall" dhe vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, i ndryshuar, për pasuritë e llojit "ndërtesë", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 2,754,738 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT

	"Sistemim i bllokut të banimit në lagjen 'Xhevdet Nepravishta' kufizuar me rrugën 'Ahmet Zogu', rrugën 'Misto Mame' dhe shëtitoren 'Kongresi'", Lushnjë											
Nr.	**Emër mbiemër**	**Lloji i pasurisë**	**Z.K.**	**Nr. i pasurisë**	**Sip. e truallit m²**	**Çmimi i truallit lekë/m²**	**Vlera e truallit**	**Sip. ndërtesës m²**	**Çmimi i ndërtimit**	**Vlera e ndërtesës lekë**	**Vlera totale truall dhe ndërtesë lekë**	**Shënime Sqaruese**
1	Mondi Pëllumb Xhelali	Truall + ndërtesë	8571	22/31	81	9709	786429	81		1968309	2754738	Vërtetim hipotekor
VLERA TOTALE PARAPRAKE							786429	**81**		1968309	2754738	

Shënime.
1. Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000

2. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë truall", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.